



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 921 prot.

Gjirokastrë, më 03. 11 .2025

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara te Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

KËSHILLIT TË BASHKISË PËRMET

Përmet

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara te prefekti i qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 87, datë 22.10.2025 “Për miratimin e fazes së dytë të buxhetit afatmesëm 2026-2028”, konfirmohet.
 2. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 88, datë 22.10.2025 “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të bazës materiale inventariale të dëmtuar”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.
 3. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 89, datë 22.10.2025 “Për një ndryshim në vendimin nr. 96, datë 27.11.2024, ‘Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, Bashkia Përmet, viti 2025’”, nuk konfirmohet.
- Vendimi i Këshillit Bashkiak bie ndesh me nenin 26, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për taksat vendore”, të ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel” dhe ‘Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel’. Në bazë të aneksit 8, të ligjit të mësipërm, përcaktohet se taksa llogaritet në lekë për natë fjetjeje për person dhe kategorizimi i vlerës së taksës bëhet sipas llojit të hotelit, me 4 a 5 yje dhe nën 4 yje.
4. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 90, datë 22.10.2025 “Për miratimin në parim të përcaktimit të vendit të përkohshëm të grumbullimit dhe asgjësimit të kadavrave”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

5. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 91, datë 22.10.2025 “Për miratimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile Bashkia Përmet 2025-2028”, konfirmohet.
6. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 92, datë 22.10.2025 “ “Për miratimin e përdorimit të fondit rezervë për dhënie ndihmë financiare”, konfirmohet.
7. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 93, datë 22.10.2025 “ “Për një ndryshim në VKB nr. 107, datë 18.12.2024 Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, njësive administrative dhe institucioneve në varësi të saj”, i ndryshuar”, konfirmohet.
8. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 94, datë 22.10.2025 “Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri 6%”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.
9. Vendimi i këshillit të bashkisë nr. 95, datë 22.10.2025 “Për miratimin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë muaji tetor 2025”, është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Odise Kote

